



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.90, datë 02.05.2023

PËR
“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM TË KËSHILLIT
TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITET 2024-2026”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 pika 2, germa “d” dhe 188 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.195, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe Udhëzimin Nr.5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2016” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë sipas tabelës së mëposhtme, në mijë lekë:

Artikujt	Buxheti	PBA 2024- 2026		
	2023	2024	2025	2026
Paga (600-601)	132,517	144,407	144,407	144,407
Korrente të tjera (602-606)	25,083	35,000	35,000	35,000
Kapitale (230-232) të brendshme	15,000	10,000	10,000	10,000
Kapitale (230-232) të huaja	0,0	0,0	0,0	0,0
Jashtëbuxhetore				
Totali	172,600	189,407	189,407	189,407

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 02.05.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

